



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve  
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

## **STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL**

### **KUZHINË**

**Niveli i tretë në KSHK<sup>1</sup>, referuar nivelit III të KEK<sup>2</sup>**

**K-G8-III-24**

**Hartuar në kuadër të zbatimit të sistemit dual, me mbështetjen e Projektit “Aftësi për Punë”, financuar nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SDC) dhe zbatuar nga Swisscontact**

**Tiranë më, 2024**

---

<sup>1</sup> Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

<sup>2</sup> Korniza Evropiane e Kualifikimeve

## Përmbajtja

Emërtimi i kualifikimit .....	4
Kodi.....	4
Kohëzgjatja .....	4
Niveli.....	4
Qëllimi: .....	4
Kriteret e përgjithshme të pranimit: .....	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit: .....	4
Ofruesit .....	4
Data e validimit.....	4
Data e miratimit .....	4
Variantet e mëparshme .....	4
<b>STRUKTURA E KUALIFIKIMIT .....</b>	<b>5</b>
Kompetenca të përgjithshme.....	5
<b>NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL: .....</b>	<b>5</b>
<b>G8-07-III-0075-24 Planifikimi dhe organizimi i punës në kuzhinë .....</b>	<b>5</b>
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	5
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	6
Kriteret e vlerësimit .....	7
<b>G8-07-III-0076-24 Shitje dhe marketing .....</b>	<b>7</b>
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	7
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	8
Kriteret e vlerësimit .....	8
<b>G8-33-III-0015-24 Siguria ushqimore dhe garantimi i cilësisë.....</b>	<b>9</b>
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	9
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	9
Kriteret e vlerësimit .....	10
<b>G8-07-III-0016-24 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit .....</b>	<b>10</b>
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	10
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	11
Kriteret e vlerësimit .....	11
<b>G8-31-III-0014-24 Komunikimi dhe etika profesionale .....</b>	<b>11</b>
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	11
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	12
Kriteret e vlerësimit .....	12

<b>G8-34-III-0077-24 Anglishte teknike</b> .....	12
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	13
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	13
Kriteret e vlerësimit .....	13
<b>G8-35-III-0078-24 Të ushqyerit</b> .....	14
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	14
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	14
Kriteret e vlerësimit .....	15
<b>G8-07-III-0079-24 Teknikat për përgatitjen e gatesave në kuzhinë</b> .....	15
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	15
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	16
Kriteret e vlerësimit .....	18
<b>G8-32-III-0013-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere</b> .....	19
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	19
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	19
Kriteret e vlerësimit .....	20
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse: .....	20
Modalitetet e vlerësimit .....	20
Informacion shtesë .....	21
<b>SHËNIM</b> .....	21

Emërtimi i kualifikimit	Kuzhinë			Kodi
	Kohëzgjatja	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	
	2800-3300 orë <sup>3</sup>			K-G8-III-24
<b>Qëllimi:</b>	<p>Qëllimi kryesor i arsimimit në kualifikimin profesional “Kuzhinë”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është <i>“përgatitja profesionale e individëve për t’u punësuar në veprimtaritë që lidhen drejtpërdrejt me fushën e kuzhinës si punonjës të kualifikuar dhe zhvillimi i personalitetit të tyre për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.</i> Zhvillimi te individit i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gatishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimet emocionale, intelektuale dhe një shkallë të gjerë njohurish profesionale janë sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi.</p>			
<b>Kriteret e përgjithshme të pranimit:</b>	<p>Në institucionet që ofrojnë arsim profesional në kualifikimin profesional “Kuzhinë”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kanë mbaruar arsimin bazë;</li> <li>- janë në gjendje shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.</li> </ul>			
<b>Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:</b>	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimin profesional “Kuzhinë”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën e Maturës Shkollore Profesionale (shkollës së mesme) dhe suplementin përkatës.</p> <p>Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në sektorin e mikpritjes, restorante, bare, bistro, mensa, bujtina, shtëpi pritëse, fjetina, fshat turistik, hotel, motel, resort, qendër kurative, kamping, agroturizëm, mensa, kroçere, në industrinë e kateringut si dhe në veprimtari të tjera që ushtrohen në këtë drejtim. Gjithashtu, individit mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e shërbimeve të mikpritjes.</p> <p>Përfundimi i këtij niveli, lejon kalimin në nivel më të lartë të arsimit profesional, në kursin urë të përgjithshëm, në nivelin IV të KSHK-së, referuar nivelit IV të KEK, për të fituar të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”.</p>			
<b>Ofruesit</b>	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
<b>Data e validimit</b>	Korrik 2024			
<b>Data e miratimit</b>				
<b>Variantet e mëparshme</b>				

<sup>3</sup> Orë mësimore 45 min.

## **STRUKTURA E KUALIFIKIMIT**

Në përfundim të kualifikimit profesional “Kuzhinë” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi duhet të zotërojë njohuritë, shprehjet profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas fushave të mëposhtme:

### **Kompetenca të përgjithshme**

*Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.*

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
2. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
3. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
4. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
5. Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
6. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
7. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
8. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
9. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
10. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
11. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
12. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
13. Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij, për t'u përshtatur me evolucionin teknologjik.

### **NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:**

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

### **G8-07-III-0075-24 Planifikimi dhe organizimi i punës në kuzhinë**

#### **Rezultatet e të nxënit në njohuri**

1. Të shpjegojë rëndësinë njohjes së historisë dhe zhvillimit të kuzhinës dhe gastronomisë;
2. Të shpjegojë rëndësinë e kuzhinës shqiptare bazuar në kërkesat e klientëve për të;
3. Të shpjegojë rëndësinë e pozicionimit të kuzhinës brenda strukturës dhe reparteve/sectorëve të saj;
4. Të dallojë repartet/sectorët ku punon kuzhinieri;
5. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit të veprimtarisë në kuzhinë, të burimeve, mjeteve të nevojshme, si dhe nevojave për staf;
6. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregullores së brendshme në kuzhinë;
7. Të përshkruajë detyrat e punonjësve të kuzhinës sipas hierarkisë (brigada e kuzhinës);

8. Të shpjegojë rëndësinë e koordinimit të punëve midis kolegëve dhe reparteve për optimizimin e shitjeve ditore (takimi ditor);
9. Të shpjegojë mënyrën e veshjes dhe mirëmbajtjes së uniformës profesionale së kuzhinierit;
10. Të përshkruajë rregullat e higjienës personale;
11. Të dallojë pajisjet kryesore të përcaktuara sipas sektorëve dhe përdorimit të tyre (mjete, pajisje pune dhe makineri, pajisje gatimi);
12. Të shpjegojë rregullat e përdorimit dhe sistemimit të mjeteve, pajisjeve matëse e prerëse dhe makinerive në kuzhinë;
13. Të përshkruajë rregullat e higjienës mjeteve të punës, pajisjeve dhe vendit të punës në kuzhinë;
14. Të shpjegojë llojet e dokumentacionit teknik dhe financiar, si dhe rëndësinë e përdorimit të tyre në kuzhinë;
15. Të dallojë lëndët e para dhe ndihmëse;
16. Të shpjegojë rëndësinë e leximit dhe interpretimit të etiketës së ambalazheve;
17. Të përkufizojë konceptet menu, plan prodhimi, plan ditor dhe recetë;
18. Të dallojë menutë sipas llojit të aktivitetit;
19. Të përshkruajë rëndësinë e hartimit dhe skicimit të menisë;
20. Të përshkruajë konceptet kryesore për krijimin kreativ dhe të suksesshëm të menisë;
21. Të përshkruajë mënyrën e hartimit të planit të prodhimit dhe zërthimit të tij;
22. Të përshkruajë rëndësinë e hartimit të planit-ditor të veprimtarive në kuzhinë;
23. Të shpjegojë rëndësinë e hartimit të fletë-kërkesës për lëndët e para, ndihmëse dhe materiale të tjera;
24. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të tabelës së firove në kuzhinë;
25. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të librit të normativave në kuzhinë;
26. Të shpjegojë rëndësinë e llogaritjes së kostos për asortimentet në kuzhinë;
27. Të shpjegojë rëndësinë e shfrytëzimit maksimal të lëndëve të para dhe ndihmëse në kuzhinë;
28. Të shpjegojë rëndësinë e hartimit të katalogut me prezantime të gatesave, në kuzhinë;
29. Të vlerësojë trendet e zhvillimit dhe inovacionit në industrinë e mikpritjes dhe përdorimit të teknologjinë për të optimizuar operacionet;
30. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të TIK dhe microsoft word në kuzhinë;

### **Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale**

1. Të planifikojë veprimtaritë, burimet, mjetet e nevojshme në kuzhinë, si dhe nevojat për staf;
2. Të zbatojë rregulloren e brendshme në kuzhinë;
3. Të zbatojë detyrat sipas pozicionit të punëve në kuzhinë;
4. Të koordinojë veprimet midis kolegëve dhe reparteve për optimizimin e shitjeve ditore (takimi ditor);
5. Të veshë e të mirëmbajë uniformën profesionale sipas rregullit;
6. Të zbatojë rregullat e higjienës personale;
7. Të përdorë mjetet dhe pajisjet kryesore sipas sektorëve në kuzhinë;
8. Të përdorë pajisjet matëse dhe prerëse në kuzhinë;
9. Të zbatojë rregullat e higjienës së mjeteve, pajisjeve dhe vendit të punës në kuzhinë;
10. Të përdorë dokumentacionin teknik dhe financiar në kuzhinë;
11. Të përzgjedhë lëndët e para dhe ndihmëse dhe t'i përdorë ato në mënyrë efikase;

12. Të interpretojë etiketën e ambalazheve të lëndëve të para dhe ndihmëse në kuzhinë;
13. Të dallojë menutë sipas llojit të aktivitetit;
14. Të ndajë detyrat sipas planit-ditor të veprimtarive në kuzhinë;
15. Të hartojë planin e prodhimit;
16. Të hartojë fletë-kërkesën për lëndët e para, ndihmëse dhe materiale të tjera;
17. Të llogarisë koston për asortimentet e përgatitura në kuzhinë;
18. Të përdorë katalogun me prezantime të gatesave në kuzhinë;
19. Të përdorë teknologjinë për të optimizuar operacionet;

### **Kriteret e vlerësimit**

- Zbaton rregullat në kuzhinë sipas rregullores e brendshme;
- Zbaton detyrat në kuzhinë sipas pozicionit të punëve;
- Koordinon veprimet midis kolegëve dhe reparteve për optimizimin e shitjeve ditore (takimi ditor);
- Vesh e mirëmban uniformën profesionale sipas rregullit;
- Zbaton rregullat e higjienës personale sipas standardit;
- Përdor mjetet dhe pajisjet kryesore sipas reparteve, sektorëve;
- Përdor pajisjet matëse dhe prerëse në kuzhinë sipas rregullit;
- Zbaton rregullat e higjienës së mjeteve, pajisjeve dhe vendit të punës sipas standardit;
- Përdor dokumentacionin teknik dhe financiar në kuzhinë sipas rregullit;
- Përzgjedh lëndët e para dhe ndihmëse sipas recetës;
- Interpreton etiketën e ambalazheve të lëndëve të para dhe ndihmëse në kuzhinë;
- Dallon menutë sipas llojit të aktivitetit;
- Planifikon detyrat sipas planit-ditor të veprimtarive në kuzhinë;
- Harton planin e prodhimit sipas rregullit;
- Harton fletë-kërkesën për lëndët e para, ndihmëse sipas rregullit;
- Llogarit koston për gatesat e përgatitura në kuzhinë sipas rregullit;
- Përdor katalogun me prezantime të gatesave sipas rregullores së kompanisë;
- Përdor teknologjinë për të optimizuar operacionet sipas veprimtarisë së kompanisë;

### **G8-07-III-0076-24 Shitje dhe marketing**

#### **Rezultatet e të nxënësimit në njohuri**

1. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit të buxhetit dhe parashikimit të të ardhurave;
2. Të shpjegojë kuptimin mbi konceptet për efikasitetin, produktivitetin dhe rentabilitetin;
3. Të shpjegojë kuptimin mbi konceptet për kërkim tregu, planifikim, promovim, shërbim ndaj klientit me cilësi;
4. Të shpjegojë rëndësinë e qëndrueshmërisë së kompanisë në treg;
5. Të vlerësojë rëndësinë e gjenerimit të të ardhurave edhe nga burime të tjera alternative;
6. Të shpjegojë rëndësinë e departamentit Food&Beverage në përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të koston;
7. Të shpjegojë rëndësinë e departamentit F&B në rritjen e të ardhurave të kompanisë dhe krijimit të marrëdhënieve afatgjata me klientët;
8. Të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit midis nën departamenteve dhe personelit të tyre;

9. Të shpjegojë rëndësinë e uljes së konsumit të ujit dhe të energjisë, për ulje të kostove të kompanisë;
10. Të shpjegojë rëndësinë e marketingut dhe ndikimin e tij në industrinë e mikpritjes;
11. Të listojë funksionet dhe instrumentet e marketingut;
12. Të vlerësojë rëndësinë e përdorimit të elementëve dhe kanaleve të marketingut për shitje;
13. Të shpjegojë rëndësinë e monitorimit të tregut për çmimet dhe cilësinë;
14. Të shpjegojë rëndësinë e politikave të formimit dhe diferencimit të çmimeve;
15. Të shpjegojë politikat e kompanisë për blerjet dhe magazinimin të lëndëve të para, ndihmëse, mjeteve dhe materialeve;
16. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të politikave të marketingut në tregun vendas, rajonal dhe ndërkombëtar;
17. Të shpjegojë rëndësinë e pjesëmarrjes në procesin e hartimit të materialeve promovuese;
18. Të përshkruajë teknika dhe forma të marketingut të shërbimeve;
19. Të shpjegojë rëndësinë e web-it për shitjet dhe marketingun e kompanisë;

### **Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale**

1. Të kryejë veprimtari që garantojnë qëndrueshmërinë e kompanisë në treg;
2. Të përdorë elementë të marketingut për shitje, gjatë veprimtarisë në industrinë e mikpritjes;
3. Të monitorojë tregun për çmimet dhe cilësinë;
4. Të bashkëpunojë me kolegët gjatë planifikimit të buxhetit dhe parashikimit të të ardhurave;
5. Të respektojë strategjinë e ndjekur nga kompania, për blerjet dhe ruajtjen e lëndëve të para, ndihmëse, mjeteve dhe materialeve;
6. Të bashkëpunojë personelin e departamenteve të tjera;
7. Të përdorë me efikasitet konsumin e ujit dhe të energjisë, për uljen e kostove të kompanisë;
8. Të bashkëpunojë me kolegët për llogaritjen e shpenzimeve të një veprimtarie;
9. Të zbatojë politikat e marketingut;
10. Të koordinojë punën me kolegët për hartimin e materialeve promovuese;
11. Të zbatojë teknika dhe forma të marketingut të shërbimeve që ofron struktura hoteliere;
12. Të bashkëpunojë për mirëmbajtjen e web-it;

### **Kriteret e vlerësimit**

- Përdor elementë të marketingut për shitje, gjatë veprimtarisë në industrinë e mikpritjes;
- Monitoron periodikisht tregun, për çmimet dhe cilësinë;
- Bashkëpunon me kolegët për planifikimin e buxhetit dhe parashikimin e të ardhurave, sipas departamenteve;
- Bashkëpunon me departamentet e tjera, për qarkullimin e lëndëve të para, ndihmëse, mjeteve dhe materialeve, sipas politikave të kompanisë;
- Kujdeset për uljen e konsumit të ujit dhe të energjisë, për uljen e kostove të kompanisë;
- Bashkëpunon me departamentet dhe sektorët e tjerë, për llogaritjen e shpenzimeve të një veprimtarie, sipas kërkesave të klientit;
- Bashkëpunon me kolegët për hartimin e materialeve promovuese;
- Bashkëpunon me kolegët për mirëmbajtjen dhe rifreskimin e web-it, sipas politikave të kompanisë;

- Zbaton teknika dhe forma të marketingut të shërbimeve, sipas politikave të kompanisë;

### **G8-33-III-0015-24 Siguria ushqimore dhe garantimi i cilësisë**

#### **Rezultatet e të nxënit në njohuri**

1. Të dallojnë autoritetet shqiptare dhe evropiane të sigurisë ushqimore;
2. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të ligjeve shqiptare dhe ndërkombëtare për garantimin e sigurisë dhe cilësisë;
3. Të shpjegojë parimet, kriteret dhe procedurat e zbatimit të standardit HACCP;
4. Të shpjegojë karakteristikat të lëndëve të para dhe ndihmëse;
5. Të dallojë skemat e cilësisë së klasifikimit të produkteve shqiptare;
6. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të lëndëve të para, organike, të zonës dhe të sezonit;
7. Të shpjegojë rëndësinë e vlerësimit organo-shqisor të lëndëve të para dhe ndihmëse në kuzhinë, për të garantuar cilësinë e gatesave;
8. Të theksojë rëndësinë e ruajtjes së lëndëve të para dhe ndihmëse, si dhe produkteve gjysmë të gatshme dhe të gatshme;
9. Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së vlerave ushqimore gjatë përpunimit të lëndëve të para dhe ndihmëse;
10. Të shpjegojë rëndësinë e pasterizimit të vezëve;
11. Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së kampionit të ushqimeve, për sigurinë ushqimore;
12. Të shpjegojë mënyrat e ambalazhimit të gatesave;
13. Të përshkruajë rëndësinë e garantimit të cilësisë gjatë proceseve të përgatitjes dhe shërbimit të ushqimeve;
14. Të shpjegojë procedurat për përgatitjen dhe shërbimin e ushqimeve për klientët VIP;
15. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të procedurave për garantimin e sigurisë dhe shëndetit të klientëve në industrinë e mikpritjes;
16. Të shpjegojë rëndësinë e kryerjes së procesit të filtrimit të ujit që përdoret në industrinë e mikpritjes;
17. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të protokolleve të duhura në raste pandemie në industrinë e mikpritjes;

#### **Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale**

1. Të zbatojë ligjet shqiptare dhe ndërkombëtare për garantimin e sigurisë dhe cilësisë;
2. Të zbatojë parimet, kriteret dhe procedurat e standardit HACCP;
3. Të vlerësojë karakteristikat cilësore të lëndëve të para dhe ndihmëse;
4. Të përdorë produkte shqiptare sipas skemave dhe klasifikimit të cilësisë;
5. Të përdorë lëndë të para, organike, të zonës dhe të sezonit;
6. Të kryejë vlerësimin organo-shqisor të lëndëve të para dhe ndihmëse në kuzhinë, për të garantuar cilësinë e gatesave;
7. Të zbatojë procedurat e ruajtjes së lëndëve të para dhe ndihmëse, si dhe produkteve gjysmë të gatshme dhe të gatshme;
8. Të ambalazhojë gatesat e përgatitura;
9. Të kujdeset për ruajtjen e vlerave ushqimore gjatë përpunimit të lëndëve të para dhe ndihmëse;
10. Të pasterizojë vezët;
11. Të ruajë kampionin e produkteve dhe asortimenteve në kuzhinë;
12. Të zbatojë protokollin e përcaktuar në raste pandemie në kuzhinë;

### **Kriteret e vlerësimit**

- Zbaton ligjet shqiptare dhe ndërkombëtare për garantimin e sigurisë dhe cilësisë;
- Zbaton parimet, kriteret dhe procedurat e standardit HACCP;
- Vlerëson karakteristikat cilësore të lëndëve të para dhe ndihmëse sipas standardit;
- Përdor produkte shqiptare sipas skemave dhe klasifikimit të cilësisë;
- Përdor lëndë të para, organike, të zonës dhe të sezonit sipas gatesës;
- Kryen vlerësimin organo-shqisor të lëndëve të para dhe ndihmëse në kuzhinë, për të garantuar cilësinë e gatesave;
- Zbaton procedurat e ruajtjes së lëndëve të para dhe ndihmëse, si dhe produkteve gjysmë të gatshme dhe të gatshme sipas standardit;
- Kujdeset për ruajtjen e vlerave ushqimore gjatë përpunimit të lëndëve të para dhe ndihmëse sipas standardit;
- Pasterizon vezët, sipas teknikës;
- Ruan kampionin e produkteve dhe gatesave në kuzhinë sipas standardit
- Ambalazhon gatesat e përgatitura sipas standardit;
- Zbaton protokollet e përcaktuara në raste pandemie në kuzhinë, në mënyrë rigoroze;

### **G8-07-III-0016-24 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit**

#### **Rezultatet e të nxënit në njohuri**

1. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të Standardit kombëtar dhe legjislacionit shqiptar për rregullat e sigurimit teknik;
2. Të shpjegojë rregullat e sigurimit teknik në vendin e punës;
3. Të shpjegojë parimet kryesore të ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë;
4. Të shpjegojë rëndësinë e plotësimit të dokumentacionit të sigurimit teknik;
5. Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të uniformës profesionale në vendin e punës;
6. Të shpjegojë rregullat për parandalimin e aksidenteve dhe mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe klientëve;
7. Të përshkruajë sinjalistikën që përdoret në industrinë e mikpritjes;
8. Të shpjegojë procedurat e dhënies së ndihmës së parë;
9. Të përshkruajë procedurat e evakuimit nga strukturat e mikpritjes në raste të emergjencave;
10. Të përshkruajë rëndësinë e interpretimit të etiketave të detergjenteve dhe dezinfektuesve, sipas standardit D-D-D;
11. Të përshkruajë mënyrën e përdorimit të detergjenteve dhe dezinfektuesve në vendin e punës;
12. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të prioriteteve për një ekonomi të gjelbër dhe qëndrueshmëri;
13. Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së mjedisit dhe garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm;
14. Të shpjegojë rëndësinë e ndarjes së mbeturinave sipas llojit të tyre;
15. Të përshkruajë rregullat e menaxhimit të mbeturinave;
16. Të përshkruajë rëndësinë e grumbullimit të mbetjeve të gjelbra për kompostim;
17. Të shpjegojë rëndësinë e grumbullimit të yndyrave të përdorura për riciklim;
18. Të shpjegojë rëndësinë e blerjeve të lëndëve të para dhe ndihmëse, në ambalazhe të riciklueshme;

### **Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale**

1. Të zbatojë Standardin kombëtar dhe legjislacionin shqiptar për rregullat e sigurimit teknik;
2. Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në vendin e punës;
3. Të zbatojë legjislacionin për sigurinë dhe shëndetin në punë;
4. Të monitorojë vlefshmërinë e dokumentacionit të sigurimit teknik, në industrinë e mikpritjes;
5. Të përdorë uniformën profesionale në vendin e punës;
6. Të zbatojë rregullat për parandalimin e aksidenteve dhe mbrojtjes së shëndetit të punonjësve dhe klientëve;
7. Të zbatojë sinjalistikën në industrinë e mikpritjes;
8. Të zbatojë procedurat e dhënies së ndihmës së parë;
9. Të zbatojë procedurat e evakuimit nga strukturat e mikpritjes, në raste të emergjencave;
10. Të përdorë detergjenteve dhe dezinfektuesve në vendin e punës, sipas etiketës dhe standardit D-D-D (Dezinfektim-Dezinsektim-Deratizim);
11. Të zbatojë kriteret e ruajtjes së mjedisit për garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm;
12. Të ndajë mbeturinat sipas llojit;
13. Të zbatojë procedurat e grumbullimit të mbetjeve të gjelbra për kompostimit;
14. Të grumbullojë yndyrat e përdorura për riciklim;
15. Të përdorë lëndë të para dhe ndihmëse, në ambalazhe të riciklueshme;

### **Kriteret e vlerësimit**

- Zbaton Standardin kombëtar për rregullat e sigurimit teknik.
- Zbaton rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë dhe shëndetit në punë, sipas legjislacionit në fuqi;
- Monitoron periodikisht afatet e vlefshmërisë së dokumentacionit të sigurimit teknik, në industrinë e mikpritjes;
- Përdor uniformën profesionale, sipas sektorëve;
- Zbaton rregullat për parandalimin e aksidenteve dhe mbrojtjes së shëndetit të punonjësve dhe klientëve, sipas legjislacionit në fuqi;
- Zbaton sinjalistikën në industrinë e mikpritjes, sipas standardeve;
- Zbaton procedurat e dhënies së ndihmës së parë, sipas legjislacionit në fuqi;
- Zbaton procedurat e evakuimit nga strukturat e mikpritjes, sipas llojit të emergjencave;
- Zbaton kriteret e ruajtjes së mjedisit për garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm;
- Përdor detergjente dhe dezinfektues në vendin e punës, sipas etiketës dhe standardit D-D-D;
- Ndan mbeturinat sipas llojit;
- Zbaton procedurat e duhura për grumbullin e mbetjeve të gjelbra për kompostim;
- Grumbullon yndyrat e përdorura për riciklim, sipas procedurave;
- Përdor lëndë të para dhe ndihmëse në ambalazhe të riciklueshme;

### **G8-31-III-0014-24 Komunikimi dhe etika profesionale**

#### **Rezultatet e të nxënit në njohuri**

1. Të shpjegojë parimet e etikës profesionale në punë (konfidencialiteti, besueshmëria etj.);

2. Të përshkruajë rregullat e një komunikimi të suksesshëm dhe rëndësinë e zbatimit të tyre;
3. Të shpjegojë rëndësinë e marrjes dhe përcjelljes së mesazheve të qarta në një komunikim;
4. Të shpjegojë format e komunikimit verbal dhe jo-verbal;
5. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të gjuhës së trupit (Body language, toni i zërit, mimika) në procese të ndryshme në vendin e punës;
6. Të shpjegojë rëndësinë e dëgjimit aktiv dhe të vëmendshëm gjatë komunikimit;
7. Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit gjatë bashkëveprimit dhe koordinimit të veprimtarive me departamente dhe sektorë të tjerë si dhe me institucione;
8. Të shpjegojë rëndësinë e paraqitjes, vëmendjes, përpikmërisë, ndershmërisë dhe integritetit të personelit në industrinë e mikpritjes;
9. Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të kulturave dhe traditave të klientëve;
10. Të shpjegojë rëndësinë e zgjidhjes së ankesave dhe mosmarrëveshjeve me klientët;
11. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
12. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të parimeve të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët.

### **Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale**

1. Të zbatojë parimet e etikës profesionale në punë (konfidencialitetin, besueshmërinë etj.);
2. Të marrë dhe përcjellë mesazheve të qarta në një komunikim;
3. Të zbatojë format e komunikimit verbal dhe jo-verbal;
4. Të përdorë gjuhën e trupit me etikë (Body language, toni i zërit, mimika) në vendin e punës;
5. Të dëgjojë në mënyrë aktive gjatë komunikimit;
6. Të komunikojë me etikë profesionale gjatë koordinimit të veprimtarive me eprorët dhe vartësit;
7. Të respektojë kulturat dhe traditat e klientëve;
8. Të zgjidhë ankesat dhe mosmarrëveshjet me klientët;
9. Të përdorë rregullisht terminologji profesionale;
10. Të zbatojë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët;

### **Kriteret e vlerësimit**

- Zbaton parimet e etikës profesionale në punë (konfidencialitetin, besueshmërinë etj.);
- Merr dhe përcjell mesazhe të qarta komunikimi, sipas standardit;
- Zbaton format e komunikimit me klientët dhe kolegët, sipas standardit;
- Përdor gjuhën e trupit me etikë (Body language, toni i zërit, mimika) në vendin e punës;
- Dëgjon në mënyrë aktive gjatë komunikimit;
- Komunikon me etikë profesionale gjatë bashkëpunimit me kolegët dhe vartësit;
- Respekton kulturat dhe traditat e klientëve, për të garantuar shërbim cilësor;
- Zgjidh ankesat dhe mosmarrëveshjet me klientët, duke përdorur teknikat e duhura.
- Përdor rregullisht terminologji profesionale, sipas rregullit
- Veprojnë në përputhje me parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët.

### **G8-34-III-0077-24 Anglishte teknike**

### **Rezultatet e të nxënit në njohuri**

1. Të shpjegojë rregullat bazë të komunikimit në gjuhë angleze gjatë mikpritjes së klientit;
2. Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit në gjuhë angleze gjatë marrjes së informacioneve të nevojshme nga klienti dhe kërkesave të tij;
3. Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit në gjuhë angleze për informimin e klientit në lidhje me shërbimet që ofrohen;
